

HYRJA NË LABORATORIN INTERAKTIV PERSONAL

“ROSETTA STONE – TMM CAMPUS ONLINE”


Hyrja në Laborator bëhet përmes **kodit personal**. **Herën e parë**, duhen kaluar disa etapa. **Herët e tjera**, thjesht vazhdoni punën atje ku e patët ndërprerë herën e kaluar, ose zgjidhni dicka tjetër. Mund të punohet me **çdo lloj instrumenti digjital, që është i lidhur në internet**.




Pas dy ose tri seancash pune, **orientimi** në Laborator do t’ju bëhet **shprehi** dhe ju do ta gjeni shpejt veten në mënyrën e të punuarit. Megjithatë, si fillim mund të ndiqni udhëzimet në vijim.

HERA E PARË


1. **Shkruani adresën:** <http://www.tellmemorecampus.com> (Për **ushtrimet interaktive** ku përdoret **zëri juaj**, ju sugjerojmë që të punoni në **Mozilla Firefox** ose **Internet Explorer**). Në ekran shfaqet porta e hyrjes.



2. **Shkruani Kodin personal** (Username, Password) dhe **klikoni mbi Sign In** Në varësi të kompjuterit që jeni duke përdorur, **mund të shfaqet** procedura e treguar në vijim, e cila shërben për **aktivizimin e mikrofonit**.



Në këtë rast mjafton që të klikoni mbi rubrikat 1, 2, 3, 4 (siç tregohet në figurë). Në ekran do të shfaqen emrat e të gjitha gjuhëve që keni në dispozicion.




Select a language to learn

- British English
- English
- French
- German
- Italian
- Spanish

- Zgjidhni gjuhën e portalit** (klikoni te rubrika që mban emrin tuaj, lart djathtas ekranit, dhe zgjidhni gjuhën përkthyesë që dëshironi).
- Zgjidhni gjuhën mësimore** (p.sh. anglishte britanike) dhe klikoni mbi **OK**. Do të shfaqen rubrikat si në vijim.

For which situation do you need your language training?



Professional Situations

Everyday Situations


- Zgjidhni llojin e situatave mësimore** me të cilat dëshironi që të filloni. Për shembull, klikoni mbi **“Everyday situations”** dhe pastaj mbi **“Vazhdo”**. Do të shfaqen rubrikat si në vijim.

Don't know your level?

Take an online placement test. This test lasts between 20 and 45 minutes.

[Continue the Test](#)

Your level:



Beginner - A1

Intermediate - A2

Proficient - B1

Advanced - B2

Expert - C1

Këtu keni dy mundësi:

- OSE testoni veten**, për të matur nivelin tuaj fillestar. Klikoni mbi kuadratin **“Fillo testin”** (majtas ekranit) dhe bëni testin. Pastaj ndiqni udhëzimet që do të shfaqen në ekran.
- OSE zgjidhni vetë** një nivel të caktuar. Theksojmë se **keni të drejtë** që të punoni **në të gjithë nivelet**, pa asnjë kufizim, pavarësisht radhës që ndiqni në përzgjedhjen e tyre.

Supozojmë që nivelin e zgjidhni vetë, p.sh. “Proficient – B1”. Atëherë, klikoni anash etiketës “**Proficient – B1**” dhe pastaj mbi “**Vazhdo**”. Shfaqen rubrikat e mëposhtme.

Which skills would you like to work on?

<input type="checkbox"/> Reading & Writing	(i)
<input checked="" type="checkbox"/> Speaking & Listening	(i)
<input type="checkbox"/> Vocabulary	(i)
<input checked="" type="checkbox"/> Grammar	(i)
<input checked="" type="checkbox"/> All skills	(i)

Choose the themes of the videos you would like to work on:

<input type="checkbox"/> Videos about Culture and Society	(i)
<input checked="" type="checkbox"/> Videos about Space	(i)
<input type="checkbox"/> Videos about Politics and the Economy	(i)
<input type="checkbox"/> Videos about Science	(i)

6. Zgjidhni aftësitë e komunikimit që dëshironi të zhvilloni.

Ju mund t'i zhvilloni këto aftësi **veç e veç dhe/ose bashkërisht**. Keni të drejtë që të punoni me gjithçka, pavarësisht rradhës që ndiqni në përzgjedhje. Në këtë etapë, përveç llojit të aftësive, ju mund të zgjidhni edhe **video tematike**, nga fusha të ndryshme. Për **të gjitha** këto zgjedhje, ose qoftë edhe **vetëm për njerën** prej tyre, **klikoni mbi kutizat/kutizën** për bri emërtimit përkatës. Pastaj klikoni « **Vazhdo** ». Shfaqen të gjitha **temat mësimore** të zgjedhura deri këtu. Jepet edhe **koha** e domosdoshme për kryerjen e tyre (si në shembull).



Estimated length of selected content: 32h 29m

All skills

- Introductions
- The Family
- Going on Vacation
- A City Tour
- Introducing Oneself
- Cultural Exercises


Klikoni mbi « Konfirmo », që të vazhdoni më tej, ose klikoni mbi « **Anulo** », që të ktheheni pas dhe t'i ndryshoni zgjedhjet tuaja. Nëse klikoni mbi “Konfirmo”, në vijim shfaqet **Platforma Qëndrore**.

Hap pas hapi do të zbuloni vetë të gjitha funksionet e rubrikave të Platformës Qëndrore.

HERËT E TJERA

Theksojmë se, **pas herës së parë**, veprimet janë shumë të thjeshta:

Shkruani adresën, vendosni kodin, zgjidhni gjuhën mësimore dhe hyni direkt te Platforma Qëndrore.



PËRDORIMI I SMARTPHONE

Keni dy mundësi për të punuar me **smartphone**:

1. OSE shkruani adresen: <http://www.tellmemorecampus.com> dhe zbatoni procedurën si më lart. Kështu, **edhe në smartphone** ju mund të punoni në **të gjitha gjuhët dhe rubrikat** (përveç ushtrimeve me njohje zanore).
2. OSE hyni në **AppStore** dhe shkarkoni **“RS Advantage Companion”**(Education). Përdorimi i këtij aplikacioni bëhet i mundur *pasi të keni kryer të paktën një seancë pune* në Laboratorin tuaj Personal. Shkarkimi është falas. Në ekranin e telefonit tuaj do të instalohet **logo e Rosetta Stone ADVANTAGE**. Kështu, sa herë që dëshironi të kryeni ushtrimet që ju ofrohen në aplikacionin e lartpërmendur, klikoni direkt mbi logon e instaluar në smartphone, shkruani kodin personal dhe vazhdoni me ushtrimet që shfaqen në ekran.

Për gjithçka që lidhet me përdorimin e këtij Laboratori gjuhësor, mund të na shkruani në adresën : koralinc@yahoo.fr